



01Nr. 104/02-1953/24

Kaçanik, 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 17, shkronja (o) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe të nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe shkronja (o) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit që Kuvendi Komunal Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 janar 2024, merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut**

1. Me këtë Vendim, EMËROHET Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje:
  - 1.1 Rrustem Zenuni anëtar (PDK)
  - 1.2 Besnik Salihu anëtar (LDK)
  - 1.3 Valon Raka anëtar (OJQ/Shoqëria Civile)
  - 1.4 Shkodran Sopa anëtar (Ekzekutivi)
  - 1.5 Kaltrina Çaka anëtare (Ekzekutivi)
2. Detyrë e Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi është që të bëjë organizimin, grumbullimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave në territorin e Komunës së Kaçanikut .
3. Komisioni për punën e vetë raporton para Kuvendit të Komunës.
4. Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të hartoj dhe miratoj kriteret e brendshme për punën e vet dhe të bashkëpunojë ngushtë edhe me ish Komisionin.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure	Nr. i aktit Org. Instrukc. Org. Ushq. Nr. i Tëpun. Bil. Shkollor. M. e Pajisje.	D2 02	M. e Pajisje. Reg. Prot. Disk. M. e Data D. e Pajisje. E. e Pajisje.	634-2/24 21.02.24
PRISHTINË / A				
Str. 1				

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL-31/24 Datë: 14.02.2024
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 104/02-1953/24 për emërtimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërtimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 31.01.2024

I nderuar kryetar Ilazi,  
I nderuar kryesues Murseli,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 05.02.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin 01 Nr. 104/02-1953/24 për emërtimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërtimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për

territorin e Komunës së Kaçanikut, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 31.01.2024

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

#### KONFIRMON

Vendimi 01 Nr. 104/02-1953/24 për emërtimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërtimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 31.01.2024.

#### ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit të cekur më lartë konstatoi se:

Vendimi është në përputhshmëri me nenin 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

